



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURENCËS

Njoftim Për Shtyp

Rasti: Përftimi i kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD.

Pranë Autoritetit të Konkurrencës është njoftuar transaksioni që do të rezultojë në përftimin e kontrollit të shoqërisë Telekom Albania SHA nga shoqëria Albania Telecom Invest AD.

Palët në marrëveshje janë:

Pala blerëse: Albanian Telecom Invest AD (ATI Bullgari) është një shoqëri aksionare e themeluar sipas legjislacionit bullgar, e krijuar rishtazi për qëllimin e transaksionit, e kontrolluar bashkërisht nga Albanian Telecom Invest Limited Qipro dhe RSC Investments.

Objekti i shoqërisë është: investim dhe aktivitet në fushën e telekomunikacionit.

Pala Shitëse: Cosmote Mobile Telecommunications SA është një shoqëri aksionare e themeluar dhe organizuar sipas ligjeve të Greqisë, e cila zotëron 99.757% të aksioneve të Telekom Albania Sha. Objekti i kësaj shoqërie është: instalimi, operimi, mirëmbajtje, menaxhim dhe zhvillim i sistemeve të telefonisë celulare dhe në përgjithësi të sistemeve të komunikimit elektronik; dizejmim, zhvillim, prodhim, furnizim, përdorim, kreditim financiar dhe mirëmbajtje të sistemeve/pajisjeve të telekomunikacionit dhe aktiviteteve që lidhen me komunikimet elektronike dhe celulare etj.

Shoqëria target: Telekom Albania SHA është një shoqëri aksionare e themeluar dhe organizuar sipas legjislacionit shqiptar, aktive në industrinë e telekomunikacionit kryesisht në sektorin e komunikimeve të telefonisë celulare, shërbimeve broadband fiks/rjet, internet, linja fiks/rjet; ndërtimi, zotërimi, operimi dhe ofrimi i rrjetit publik të telefonisë së lëvizshme të standartit GSM etj.

Më datë 15 Janar 2019, është nënshkruar “Marrëveshja për shitblerjen e aksioneve”, midis palës blerëse Albania Telecom Invest AD dhe palës shitëse Cosmote Mobile Telecommunications S.A, për blerjen e 99.757% të aksioneve të shoqërisë Telekom Albania SHA.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10 dhe 12 të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros.

Si pasojë ky transaksion është objekt autorizimi nga Komisioni i Konkurrencës.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (Nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al.